

BULETIN NR. 3



SHOQATA RYDER ALBANIA

Adresa: Rr.Vllazën Huta,Nd 90,H4

Email: info@ryderalbania.org

Tel: 0035542452309

Website: www.ryderalbania.org.al

Udhëzues për të
moshuarit: pensionet
dhe shërbimet sociale
në Bashkinë e Tiranës



BASHKIA
TIRANË

Sue Ryder Care
Albania



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Ky publikim është realizuar nga Shoqata Ryder Albania në kuadër të Projektit "Ofrimi i shërbimit të kujdesit në banesë për të moshuarit, në Tiranë" në partneritet me Bashkinë Tiranë dhe financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve realizues dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të dashur lexues!

Mirësevini në buletin tonë informues, i cili është krijuar veçanërisht për të ndihmuar të moshuarit dhe familjet e tyre në Bashkinë e Tiranës. Qëllimi ynë është t'ju ofrojmë informacione të thjeshta dhe të qarta për shërbimet sociale dhe mënyrat se si të përfitoni nga pensionet. Ne e dimë se ndonjëherë mund të jetë e vështirë të kuptohet si funksionojnë këto shërbime, prandaj kemi bërë përpjekje për ta bërë këtë buletin sa më të lehtë për t'u kuptuar. Në këtë buletin, do të gjeni informacione mbi shërbimet rezidenciale për të moshuarit, si Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë, dhe kriteret që duhet të plotësoni për të qenë pjesë e tyre. Po ashtu, do të mësoni për shërbimet ditore dhe komunitare që ofrohen në qendrat multifunktionale dhe si të aplikoni për to.

Veç kësaj, jemi të lumtur t'ju informojmë për ofrimin e shërbimit të ri të kujdesit në banesë për të moshuarit, ku ofrohen shërbime të ndryshme kujdestarie dhe mbështetje psikosociale, të cilat janë shumë të rëndësishme për jetën tuaj të përditshme.

- Për më tepër, ky buletin ju ndihmon të kuptoni më mirë përfitimet nga sigurimet shoqërore, duke përfshirë kushtet për lloje të ndryshme të pensioneve dhe mënyrat e aplikimit për to.
- Nëse keni nevojë për informacion shtesë, mos ngurroni të na kontaktoni në numrin **00355(0)42452309**. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar!

Me respekt
Shoqata Ryder Albania



www.ryderalbania.org.al

Shërbimet rezidenciale për të moshuarit:

Shërbimet në qendrat rezidenciale për të moshuarit, përfitohen nga të moshuarit që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të kenë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;
- të jenë përfitues të pensionit social ose pensionit minimal në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- të kenë të ardhura të pamjaftueshme dhe të mos zotërojnë banesë;
- të jenë të vetmuar dhe të braktisur sipas vlerësimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore.

Si aplikohet për përfitimin e shërbimit rezidencial për të moshuar?

Procesi i përfitimit të shërbimeve rezidenciale fillon me kërkesën e paraqitur nga:

- individ apo familja në nevojë për shërbimin specifik;
- punonjësi i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit;
- organizata joqeveritare dhe ofrues të shërbimeve publike e jopublike;
- punonjësi i policisë së shtetit;
- punonjësi apo institucionet që janë në kontakt me individin apo familjen në nevojë për shërbim;
- çdo person tjetër i interesuar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- certifikatë personale dhe familjare;
- fotografi (2 copë);
- raport mjekësor;
- vërtetim nga sigurimet shoqërore;
- vërtetim të gjendjes social-ekonomike të familjes;
- vërtetim nga ZRPP-ja dhe ALUIZNI për pronat që ka në zotërim;
- vërtetim nga sistemi bankar të burimeve financiare.



Shërbimet ditore dhe komunitare:

- **Qendra Sociale Multidisiplinare**, Rruga "Maliq Muço", Nr. 19 Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë
- **Qendra Sociale Shkoze**, Rruga "Ali Shefqeti", Blloku i Banesave Sociale Shkozë, Njësia Administrative Nr. 1, Tiranë
- **Qendra Sociale "Të Qendrojmë Së Bashku"** Rruga "Sabaudin Gabrani", Ish Uzinae Drurit "Misto Mame", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë
- **Qendra Sociale "Streha Tirana"** Ndërmarrja e pjesëve të ndërrimit të Automjeteve, Shkozë, Njësia Administrative Nr. 1, Tiranë
- **Qendra Komunitare "Gonxhe Bojaxhi"** Rruga "Selaudin Bekteshi" Njësia Administrative Nr. 4, Tiranë
- **Qendra Komunitare e Terrenit** Rruga "Tefta Tashko Koço", hyrja 14, ap. 23, kati 5, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë
- **Qendra komunitare "Për personat me aftësi të kufizuar"**, Rruga "Dritan Hoxha", ish Uzina Metalike, Njësia Administrative Nr. 11, Tiranë



Kriteret e pranimit:

- të kenë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;
- të jenë përfitues të pensionit social ose pensionit minimal në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- të jenë të vetmuar dhe të braktisur sipas vlerësimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore

Shërbimet ditore dhe komunitare:

Procesi i përfitimit të shërbimeve komunitare ditore fillon me kërkesën e paraqitur nga:

- individi apo familja në nevojë;
- punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit;
- organizata joqeveritare dhe ofrues të shërbimeve publike e jopublike;
- punonjësi i policisë së shtetit;
- punonjësi apo institucionet që janë në kontakt me individin apo familjen në nevojë për shërbim;
- çdo person tjetër i interesuar.



Dokumentacioni i nevojshëm:

- certifikatë personale dhe familjare;
- fotografi (2 copë);
- raport mjekësor;
- vërtetim nga sigurimet shoqërore;
- vërtetim të gjendjes social-ekonomike të familjes
- vërtetim nga ZRPP-ja dhe ALUIZNI për pronat që ka në zotërim;
- vërtetim nga sistemi bankar të burimeve financiare.

Shërbimi në banesë për të moshuarit:

Projekti “Ofrimi i shërbimit të kujdesit në banesë për të moshuarit në Tiranë” zbatuar nga Shoqata Ryder Albania në partneritet me Bashkinë Tiranë

Shërbimet përfshijnë:

- përgatitjen e ushqimeve,
- higjienën personale,
- mirëmbajtjen e higjienës shtëpiake
- monitorimin shëndetësor,
- shërbime infermieristike,
- mbështetje psikosociale,
- pajisje mjekësore,
- aktivitete shoqërore



Orari i shërbimit: e hënë - e premte nga ora 8.30 - 16.30.

Kontakti: Shoqata Ryder Albania, tel: 00355(0)42452309.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këto shërbime, drejtohuni pranë Shoqatës Ryder Albania, njësive administrative përkatëse dhe sektorit të shërbimeve sociale.

Përfitimet nga Sigurimet Shoqërore

1. Pension pleqërie:

- **Kushtet për burra:** mosha 65 vjeç me 38 vite e 8 muaj sigurim shoqëror
- **Kushtet për gra:** mosha 61 vjeç e 10 muaj me 38 vite e 8 muaj vite sigurim shoqëror.
- **Aplikimi:** bëhet online në portalin e-Albania për lloje të ndryshme të pensioneve.



2. Pension pleqërie i reduktuar:

- **Kushtet:** të jetë i siguruar deri tre vjet para daljes në pension dhe nuk kryeni veprimtari ekonomike.
- **Aplikimi:** bëhet online në portalin e-Albania.

3. Pension familjar:

- **Kushtet:** të jeni 65 vjeç ose të paaftë për punë dhe të keni jetuar në të njëjtën familje me të ndjerin për të paktën një vit para vdekjes së tij/saj.
- **Aplikimi:** bëhet online në portalin e-Albania

4. Pension social

Kushtet:

- të keni mbushur 70 vjeç,
- të jeni me qëndrim të përhershëm në Shqipëri për pesë vitet e fundit,
- të mos plotësoni kushtet për asnjë lloj tjetër pensioni
- të mos keni të ardhura ose të ardhura më të ulëta se pensioni social.

Aplikimi: bëhet online në portalin e-Albania.



Për çdo infomacion shtesë

Drejtohuni pranë: Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

Orari i punës: e hënë-e enjte: 08.00-16.30; e premte: 08.00-14.00.

Adresa: Rruga "Muhamed Gjollesha", blloku i pallateve "Partizani", pll. 62/1, Tiranë.